

Nr. _____ prot

Belsh më: 03 . 12 .2021

AKT THEMELIMI
Për krijimin e shoqërisë tregtare
“GREEN BELSH”sh.a.

Sot, më datë ____ . ____ .2021, unë aksionari themelues, si person juridik publikë si më poshtë:

Bashkia BELSH, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), me seli në Belsh, me adresë: **Adresa: Rruga “Haziz Dervishi”, Belsh**, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Belsh, **z.Arif Tafani**.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, të ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr.9723 datë 03.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar,

Vendosi si më poshtë vijon:

NENI 1

Forma juridike

1. Të themelojmë shoqërinë tregtare **“GREEN BELSH”sh.a.** në formën e një shoqërie aksionare, me ofertë private.
2. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri **“GREEN BELSH”sh.a.**, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të shoqërisë

1. Qëllimi i krijimit të kësaj shoqërie është që nëpërmjet aktivitetit tregtar, sipas objektit të përcaktuar më poshtë, të përmbushë funksionin vendor për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore, parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike, mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake, planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj dhe shërbimin publik, sikurse parashikohet nga kuadri ligjor e nënligjor në fuqi.
2. Veprimtaria e kësaj shoqërie do të jetë me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3

Emri, logoja dhe vula e shoqërisë

1. Shoqëria do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin **“GREEN BELSH”sh.a.**
2. Ajo do të ketë logon dhe vulën e saj. Logoja do të përmbajë fjalë nga emri i shoqërisë.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

1. Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

- a) Ofrimin e shërbimeve në fushën e agroturizmit, agrikulturë, turistike ujore, trajtim diferencim të mbetjeve urbane/organike, dhe çdo investim të lidhur me to, projektim, ndërtim, rindërtim, zbatim të ndërtimeve të gjitha llojeve.
- b) Projektim, ndërtim, rindërtim, zbatim, kolaudim të ndërtimeve të gjitha llojeve duke përfshirë këtu por pa u kufizuar në ndërtim me qëllim banimi, ndërtime me karakter social, kulturor, industrial, publik kur është rasti, si dhe ndërtime të tjera me karakter tregtar.
- c) Kryerja e investimeve duke mobilizuar kapital shtetëror dhe/ose privat vendas ose të huaj.
- d) Ndërtimi, instalimi dhe mirëmbajtja e veprave, fasadave, ndërtesave publike dhe private si dhe menaxhimin e shërbimeve, mallrave dhe punimeve publike për realizimin e tyre .
- e) Kryerjen e punimeve për restaurimin e ndërtesave artistike kulturore e publike në administrim publik.
- f) Kërkime, studime, planifikim, projektim dhe drejtim të punimeve në sektorit e ndërtimit dhe inxhinierisë në përgjithësi, përfshirë të gjithë disiplinat dhe instrumente që kanë lidhje me këto fusha.
- g) Këshillimi dhe planifikimi në sektorin e shërbimeve publike dhe /ose private.
- h) Realizimin, krijimin, zhvillimin, menaxhimin dhe shitjen e projekteve, pasurive, mallrave dhe shërbimeve, për arritjen e qëllimeve dhe objektivave tregtare në përputhje me këtë statut dhe akteve ligjore në fuqi.
- i) Blerje, shitje, administrim, të materialeve dhe të çdo lloj pasurie të luajtshme dhe /ose të paluajtshme në zbatim dhe në përputhje me aktivitetin e shoqërisë.

2. Për qëllimin e realizimit të objektit të saj shoqëria mund :

- a) Të kryejë çdo aktivitet të ligjshëm që lidhet me pasuritë të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të ushtrisë të gjithë të drejtat reale të pronarit mbi to duke përfshirë por pa u kufizuar në zhvillimin, dhënien me qira, enfitozë, leasing, përdorimin, transferimin, shitjen, përdorimin si hipotekë, peng, garanci ose të përdorimit në forma të tjera të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, duke u bazuar në parimet e ruajtjes dhe garantimit të interesit publik, rritjes së vlerës ekonomike të pronës, kthimin e arsyeshëm të investimit , vlerën më të mirë të parasë si dhe leverdishmërisë publike.
- b) Në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj shoqëria me iniciativë të saj ose institucioneve të tjera identifikon zona dhe pasuri të paluajtshme me qëllim zhvillimi. Shoqëria mund të zhvillojë këto pasuri si investitorë dhe/ose zhvilluese, vete ose në bashkëpunim me sektorin publik dhe /ose privat sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- c) Me iniciativë të vetë apo propozim të subjekteve private shoqëria mund të vendos troje në pronësi të saj në dispozicion të zhvilluesit privat me qëllim zhvillimin e tyre. Forma e investimit të ndërtimit si dhe forma e bashkëpunimit përcaktohet rast pas rasti. Kushtet, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së zhvilluesit privat bëhet në bazë të parim të konkurrueshmërisë dhe të legjislacionit përkatës që rregullon këtë fushë përveç rasteve kur sipas analizës ligjore dhe/ose të studimit fizibilitetit është e pamundur që projekti të ketë

leverdishmëri nëse nuk përshtatet me rrethanat e situatave konkrete që diktojnë kontraktimin direkt me zhvilluesin. Ndërmjet zhvilluesit dhe shoqërisë nënshkruhet marrëveshja përkatëse ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve. Pasuritë e përfituara nga zhvillimi i investimi regjistrohet në emër të shoqërisë dhe ajo gëzon të gjithë tagrat e pronarit sipas legjislacionit në fuqi.

- d) Të shqyrtojë dhe të vlerësojë mundësinë e bashkëpunimit me shoqëritë e tjera tregtare dhe të gjithë format që parashikon legjislacioni në fuqi.
- e) Për qëllim të realizimit të objektit të saj shoqëria mund të aplikojë për pajisjen e shoqërisë me licenca dhe lejet e posaçme të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të saj.

3. Shoqëria, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

NENI 5

Selia e shoqërisë dhe afati i veprimtarisë

1. Selia e shoqërisë tregtare **“GREEN BELSH”sh.a.** do të jetë në Belsh, me adresë: Lagjia ***Rruga “Haziz Dervishi”***.
2. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj **për një afat kohor të pacaktuar**, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 6

Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 3.500.000 lekë (tre milion e pesëqind mijë) lekë, i cili përbëhet nga 100 aksione të zakonshme me një vlerë nominale prej 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë secili.

-Bashkia Belsh, zotëron 100% të vlerës së kapitalit të shoqërisë të barabartë me 100 aksione me vlerë të përgjithshme prej 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë, për çdo aksion të shlyer për tërësinë e vlerës nominale të tyre.

NENI 7

Përbërja e kapitalit të shoqërisë


1. Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para dhe/ose në natyrë i aksionarit themelues të kësaj shoqërie.
2. Kontributi në para do të jetë i përbërë nga shuma prej 3.500.000 lekë (tre milion e pesëqind mijë) lekë, që është edhe vlera minimale e kapitalit themeltar për shoqërinë, me ofertë private.

NENI 8

Organet drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901 datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

- Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve - organi më i lartë vendimmarrës;
- Këshilli Mbikëqyrës - organi mbikëqyrës; përbëhet nga :



- Z.Alfred Dalipi-Kryetar
- Z.Artan Spahiu-Anëtarë
- Znj.Romina Mema -Anëtarë
- Administratori - Z.Bledar Pepa - organ ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.
- Eksperti/ët kontabël I/të autorizuar.

Shoqëria është e organizuar në sistemin e administrimit me dy nivele, administrator drejton shoqërinë dhe merr vendime për mënyrën e vënies në zbatim të politikave tregtare, ndërsa këshilli mbikëqyrës, në cilësinë e organit mbikëqyrës, këqyr vënien në zbatim të këtyre politikave dhe përputhjen e tyre me ligjin dhe statutin.

Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës do të jetë 3 (tre) vjet. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen.

NENI 9

Administratori

1. Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një afat 3 (tre) vjeçar.
2. Administratori i parë i shoqërisë tregtare **"GREEN BELSH"**sh.a. është Z. Bledar Pepa.
3. Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i saj, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Eksperti kontabël

1. Asambleja e Përgjithshme ka të drejtën për të caktuar një ose disa ekspertë kontabël të zgjedhur nga listat e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.
2. Në caktimin e ekspertëve mbahen parasysh përjashtimet dhe papajtueshmëritë e përcaktuara në rregullat e posaçme. Ekspertët kontabël caktohen për një kohë që i përgjigjet një ushtrimi financiar. Ata janë të ricaktueshëm.
3. Shpërblimi i ekspertëve kontabël të autorizuar caktohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe përballohet nga shoqëria. Shoqëria tregtare **"GREEN BELSH"**sh.a., do të ketë 1 (një) ekspert kontabël.

NENI 11


Autorizimi për procedurat e themelimit

Aksionaret themelues autorizojnë Kryetarin e bashkisë për të aplikuar për regjistrimin fillestar të shoqërisë aksionare **"GREEN BELSH"**sh.a. sipas kërkesave të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

NENI 12

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 13



Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 13

Aksionari/Aksionarët themelues mund të vendosin, me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në shoqëri të tjera dhe mund të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, përveçse atij që mund të jetë konkruues me atë të shoqërisë tregtare **“BELSHI GREEN”** sh.a.

NENI 14

Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen me mirëkuptim nga aksionarët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga gjykata kompetente sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Akti i themelimit redaktohet në 4(kater) kopje origjinale, të njëjta në gjuhën shqipe.

**AKSIONARI THEMELUES
BASHKIA BELSH
PËRFAQËSUESI NGA
KRYETARI
ARIE TAFANI**



